REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

PKR.nr.157/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, sipas Kryetarit të Trupit Gjykues Kreshnik Radoniqi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Gjyljeta Çorkadiu, në lëndën penale kundër të pandehurit **B. S.** për vepër penale *posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge* nga 275 par. 1 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar. 1.8 të KPRK-së, dhe ndaj të pandehurit **K. S.** për shkak të veprës penale *ndihmë në kryerjen e veprës penale-posedim i pa autorizuar i narkotikeve, substancës psikotrope ose analoge* nga neni 275 par. 1 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar. 1.8 dhe nenin 33 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.134/16 të datës 27.07.2016, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 12.10.2016, në pranin e Prokurorit të Shtetit Valbona Disha Haxhosaj, të pandehurit B. S. dhe mbrojtësit të tij avokatit B. C., dhe të pandehurit K. S. dhe mbrojtësit të tij avokatit F. K., me datë 12.10.2016 murr dhe publikisht shpalli, dhe të njëjtën ditë e përpiloj këtë:

A K T GJ Y K I M

Të pandehurit

1. **B. S.** i lindur me datë ...., në I, i biri i A. dhe N. e lindur B., me banim në fshatin Sh, Komuna I, ka të kryer shkollën ..., me profesion ..., i gjendjes së .... ekonomike, gjendet në vuajtje të dënimit në Qendrën Korrektuese Dubravë për vepra penale të vjedhjes i gjykuar nga gjykata e Istogut, duke vuajtur dënimin prej 5 vite e 3 muaj burgim, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2. **K. S.** i lindur me datë ....., Komunën e G, tani me banim në fshatin G, Komuna F K, i biri i H. dhe E. e gjinisë P., ka të kryer shkollën ...., ka punuar si ....., i gjendjes së .... ekonomike, gjendet në vuajtje të dënimit për vepër penale të grabitjes i dënuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj me dënim prej 4 vite burgim, gjendet në vuajtje të dënimit në Qendrën Korrektuese Dubrave, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Për shkak se:

I pandehuri B.S.

1. Me datë 01.03.2016 rreth orës 14:30 në Dubravë, Komuna Istog, në Qendrën Korrektuese, pa autorizim ka poseduar substanca narkotike, në atë mënyrë që derisa ishte në sallën e krahut Jug II, e gjen dhe e merr substancën narkotike të llojit Marihuanë, e mbështjellë në formë të baterisë me izolir me ngjyrë të zezë-PVC, në sasi prej 15.47 gram,

- me çka ka kryer vepër penale *posedim i pa autorizuar i narkotikeve, substancës psikotrope ose analoge* nga neni 275 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar. 1.8 të KPRK-së.

I pandehuri K. S.

2. Me datë 21.03.2016 rreth orës 12:30 në Dubravë, Komuna Istog, në Qendrën Korrektuese, në pavijonin nr. IV, në krahun J-1, dhoma 07, me dashje ka ndihmuar të pandehurin B. në kryerjen e veprës penale duke fshehur provat, në atë mënyrë që pas marrëveshjes paraprake me te njëjtin, substancën narkotike të cilën e kishte gjetë i pandehuri B. e llojit Marihuanë, në sasi prej .... gram, e merr nga i njëjti dhe e fsheh në dhomën e tij pas radiatorit, ku edhe gjendet me rastin e kontrollit që i bëhet dhomës së të njëjtit nga Departamenti i Sigurimit i kësaj Qendre, e cila konfiskohet.

- me çka ka kryer vepër penale *ndihmë në kryerjen e veprës penale – posedim i pa autorizuar i narkotikeve, substancës psikotrope ose analoge* nga neni 275 par. 1 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar. 1.8 dhe nenin 33 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 8 par. 1, 9, 10 par. 1, 17 par. 1, 21 par. 1 dhe 2, 41, 42 par. 1 nën par. 1.1, 43 par. 1 nën par. 1.2 dhe 1.3, 45, 46, 73, 74, 75, 76 dhe 275 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar. 1.8 dhe 275 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar. 1.8 dhe nenin 33 të KPRK-së dhe nenit 245, 246, 248 par 1 dhe 4, 359, 360, 361, 365, 366, 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 te KPPRK-se, te pandehurit i

GJYKON

1. Të pandehurin B. S.

Me **DËNIM ME BURG** në kohëzgjatje prej **1 (një) viti**, të cilin dënim i pandehuri do ta mbaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe

Me **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej **500 (pesëqind) euro**, të cilin dënim i pandehuri obligohet që ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar më lartë, atëherë gjykata këtë dënim do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej 25 (njëzetepesë) ditësh, duke llogaritur një ditë burgim me 20 (njëzetë) euro të gjobës.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

2. Të pandehurin K. S.

Me **DËNIM ME BURG** në kohëzgjatje prej **7 (shtatë) muaj**, të cilin dënim i pandehuri do ta mbaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe

Me **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej **300 (treqind) euro**, të cilin dënim i pandehuri obligohet që ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar më lartë, atëherë gjykata këtë dënim do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh, duke llogaritur një ditë burgim me 20 (njëzetë) euro të gjobës.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj paushallin gjyqësor shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

***

Ndaj të pandehurit **K. S.** në kuptim të nenit 69 të KPRK-së, shqiptohet

DËNIMI PLOTËSUES – MARRJA E SENDEVE

KONFISKOHET substanca narkotike e llojit Marihuanë në peshë prej 15.47gram, të evidentuara në lëndën e Policisë së Kosovës – Njësia DHTN Pejë, me numër të rastit 2016-DHTN-089, dhe **URDHËROHET** që kjo substancë menjëherë të shkatërrohet.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë PP.I.nr.134/16 të datës 27.07.2016 kundër të pandehurve **B. S.** për vepër penale *posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge* nga 275 par. 1 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar. 1.8 të KPRK-së, dhe ndaj të pandehurit **K S** për shkak të veprës penale *ndihmë në kryerjen e veprës penale-posedim i pa autorizuar i narkotikeve, substancës psikotrope ose analoge* nga neni 275 par. 1 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar. 1.8 dhe nenin 33 të KPRK-së.

Gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me datë 12.10.2016 në praninë e Prokurorit të Shtetit, të pandehurit B. S. dhe mbrojtësit të tij avokatit B. C., dhe të pandehurit K. S. dhe mbrojtësit të tij avokatit F.K.

Para leximit të aktakuzës prokurori i shtetit bëri përmirësimin e përshkrimit faktik të dy pikave të aktakuzës, vetëm sa i përket sasisë së narkotikëve të gjetur, ashtu që në rreshtin e pestë të pikës së parë në vend të fjalës "prej 22 gram" duhet të jetë "prej 15.47 gram", si dhe në rreshtin e pestë të pikës së dytë në vend të fjalës "prej 22 gram" duhet të jetë "prej 15.47" gram. Pjesa tjetër e

aktakuzës mbetet e pandryshuar. Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit që të dy të pandehurit u deklaruan fajtor për veprat penale me të cilat akuzohen.

Pas deklarimit të pandehurve, mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, dhe propozimit të mbrojtësve që pranimi i fajësisë të aprovohet, Gjykata konstatoj se të pandehurit pranuan fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, të pandehurit janë të vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushtet nga neni 326 par. 4 të KPPRK-së, atëherë në ketë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurve se e pranojnë fajësinë, në kuptim të nenit 248 par. 4 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit B. S. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale *posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge* nga 275 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar. 1.8 të KPRK-së, dhe sa i përket te pandehurit K S qëndrojnë te gjitha elementet e *ndihmës ne kryerjen e veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge* nga 275 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar. 1.8 të KPRK-së,

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te të pandehurit ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryejnë në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që të pandehurit kanë qenë të vetëdijshëm për veprën e kryer.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurve, kështu që të njëjti janë penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për te pandehurit, gjykata ka vlerësuar sjelljen korrekte të tyre gjatë shqyrtimit fillestar duke pranuar fajësinë dhe duke u ndier të përgjegjshëm për veprimet e tyre. Gjithashtu masën e vogël të narkotikëve, rrezikshmërinë e ulët të saj dhe faktin se të njëjtit nuk janë duke konsumuar lëndë narkotike.

Si rrethana renduese për dy të pandehurit gjykata gjen se të njëjtit janë të dënuar më parë nga ana e gjykatës për vepra të vjedhjes dhe grabitjes dhe tani gjenden në vuajtje të dënimit të plotfuqishëm, të cilat i deklarojnë vetë të pandehurit gjatë seancës fillestare.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata për të pandehurit B. S. dhe K. S. ka aplikuar zbutjen e dënimit nga neni 75 i KPRK-së dhe ka ulë dënimin nën minimumin ligjor, duke vlerësuar pranimin e fajësisë, sasinë e vogël dhe rrezikshmërinë e ultë të narkotikut të gjetur si rrethanë posaçërisht lehtësuese, e me të cilin dënim do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurve është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurve në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 41 të KPPRK-së.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPPRK-se, gjykata ka përcaktuar shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor për të pandehurit secili veç e veç nga 50 euro, duke u bazuar ne shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Ndaj të pandehurit K. S. në kuptim të nenit 69 të KPRK-së, është shqiptuar edhe dënimi plotësues i marrjes së sendit, respektivisht i substancës narkotike e llojit Marihuanë ne peshë prej 15.47 gram, sende këto të evidentuara në lëndën e Policisë së Kosovës – Njësia DHTN Pejë, me numër të rastit 2016-DHTN-089.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.157/16 më datë 12.10.2016

Sekretarja Juridike	**Kryetari i Trupit Gjykues**
_____	_____
Gjyljeta Çorkadiu	**Kreshnik Radoniqi**

KËSHILLA JURIDIKE:
Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.